

## Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen



### Raport Mujor Shtator 2021

#### Informacion bazë

Administrimi i Fondit

Monedha

Vlera fillestare e kuotës

Shuma fillestare minimale

Shuma minimale pasuese

Komision në hyrje

Komision në dalje

Penalite ne rast terheqje te parakohshme

Komision Administrimi ne vit

Kosto per transferte fondesh nga pale te treta

**Shoqëria  
Raiffeisen Invest  
sh.a**

**LEK**

**1,000**

**1,000**

**1,000**

**0%**

**0%**

**Sipas rregullores  
se AMF-se**

**1.50%**

**Referojuni  
informacionit ne  
deget e RBAL**

#### Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Fondi i Pensionit Vullnetar është një mënyrë alternative kursimi, e përdorur ekskluzivisht për kursime afatgjata për vitet pas largimit përfundimtar nga puna. Ky fond zotërohet bashkërisht nga anëtarët e fondit dhe menaxhohet nga Shoqëria Administruese Raiffeisen Invest sh.a, në bazë të kontratës së lidhur me anëtarët e fondit.

Asetet e Fondit do të investohen sipas parimit të sigurisë afatgjatë dhe të një kthimi të përshtatshëm nga investimi, duke ruajtur një raport optimal mes rritjes së kursimeve për pension dhe rrezikut të marrë përsipër.

Fondi synon të ndërtojë një portofol të përbërë kryesisht nga tituj borxhi te emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me maturim afatgjatë (me maturim më të lartë se një vit).


#### Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik i ulët

Përfitimet tipike më të ulëta

Rrezik i lartë

Përfitimet tipike më të larta



**Fondi është në kategorinë e parë të Profilit të Rrezikut dhe Përfitimit, pra në kategorinë me rrezik më të ulët.**


Treguesi i rrezikut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes së luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik. Ky tregues ka për qëllim tju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen.

## Të dhëna për Fondin në 30.09.2021

<b>Vlera Neto e Aseteve</b>	<b>982,728,977.91</b>
<b>Numri i investitoreve</b>	<b>3,171</b>
<b>Cmimi i Kuotes</b>	<b>1,951.2747</b>
<b>*Kthimi vjetor nga investimi (30.09.2020 – 30.09.2021)</b>	<b>4.24%</b>

\*Komisioni i administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

## Struktura e portofolit të investimeve në 30 Shtator 2021



Ne kuader të politikës së investimit të fondit të Pensionit, investimet do të kryhen kryesisht në bono thesari dhe obligacione, të emtuara në tregun primar, duke patur parasysh që aktiviteti i tregtimit të titujve të borxhit të emtuar nga Qeveria shqiptare në treg sekondar është i kufizuar.

<i>Instrumenti</i>	<i>Ne % të Aseteve të Fondit</i>
Obligacione Thesari	99.30%
Depozita / Llogari rrjedhese	0.70%

Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy here në muaj; Obligacionet 2 vjeçare një here në muaj; 7 dhe 10 vjeçare janë me të rralla, afërsisht një here në tre muaj. Qeveria organizon ankande të obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuencë një here në 2 muaj për secilin maturitet. Strategjia e investimeve vazhdon të jetë e fokusuar në investime afatgjate.

Vlera neto e asetëve të fondit është rreth LEK 983 milionë në datë 30 Shtator 2021.

## Zhvillimet dhe ecuria e normave të interesit të titujve të Qeverisë Shqiptare gjatë muajit Shtator

Në Shqipëri numri i të infektuarëve vazhdon të rritet ndjeshëm për shkak të variantit Delta. Nga ana tjetër, procesi i vaksinimit po kryhet me ritme të shpejta në Shqipëri ashtu si dhe në shumë vende të botës.

Asetet e Fondit Pension janë të investuara vetëm në bono dhe obligacione të emtuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe për këtë arsye fondi është i ekspozuar ndaj ndryshimeve në normat e interesit të këtyre titujve. Kështu investimet e fondit nuk kanë lidhje direkte me tregjet ndërkombetare, por impaktohen kryesisht nga zhvillimet në tregun e brendshëm sic janë ndryshimet në normat e interesit të titujve të Qeverisë Shqiptare.


Pergjate muajit Shtator ne tregun vendas normat e interesit te titujve te emetuar nga Qeveria Shqiptare ishin te qendrueshme, nuk pesuan ndryshime te rendesishme ne krahesim me muajin paraardhes.

Yield-i i Bonos se Thesarit 12-mujore rezultoi ne 1.77% i pandryshuar ne krahesim me ankandin e muajit Gusht. Yield-i i Bonos 3 mujore rezultoi ne 0.93% duke u rritur me 0.07% ne krahesim me ankandin e fundit.

Ankandi i rihapur i obligacionit 2 vjeçar-i i emetuar ne LEK rezultoi ne 2.20%, i pandryshuar ne krahasim me normen e ankandit paraardhes.

Per sa i perket obligacioneve afatgjate, u zhvillua obligacioni 7-vjeçar i cili rezultoi ne 4.01% duke rrene vetem me 0.01% krahasuar me ankandin e fundit te organizuar ne Qershor. Gjithashtu u zhvillua edhe ankandi i obligacionit reference 5-vjeçar i cili rezultoi ne 3.453%, duke rrene me 0.06% krahasuar me ankandin e fundit te muajit Korrik.

Grafiku me poshte jep nje pasqyre te ecurise se normave te interesit te bonove dhe obligacioneve te thesarit te emetuar nga Qeveria Shqiptare gjate periudhes 1-vjeçare Shtator 2020 – Shtator 2021. Per obligacionet reference 3 dhe 5 vjeçare jane paraqitur yields fiks te perlogaritura nga kuotimet e kontributoreve ne fund te muajit Shtator.




## Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri në 30 Shtator 2021

Çmimi i kuotes se Fondit te Pensionit ka ndjekur nje trend rrites dhe vlera e kuotes eshte rritur me +0.35% gjate muajit Shtator.

**Kthimi vjetor neto i fondit eshte 4.24% per periudhen 30 Shtator 2020 – 30 Shtator 2021;**


Kthimi vjetor eshte me i ulet karahasuar me vitet e meparshme sepse edhe normat e interesit te titujve te Qeverise, ne te cilat fondi investon, kane qene ne rrene gjate viteve te fundit. Kthimi i fondit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut, sic jane ndryshimet ne normat e interesit te titujve te Qeverise.

### Ecuria e çmimit të kuotës Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen



Ne 30 Shtator 2021	1 Vit	2 Vjet	3 Vjet	5 Vjet	7 Vjet	8 Vjet	Qe nga lancimi i fondit (31 Dhjetor 2010)
Ne % kthim vjetor i periudhes (p.a.)	4.24%	4.48%	4.69%	4.99%	5.65%	5.68%	6.41%

### Kthimi vjetor historik i Fondit te Pensionit Vullnetar Raiffeisen per çdo vit



Anetaret e fondit te Pensionit keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate qendrimi ne fond (mundesisht deri ne moshen e pensionit, pese vjet para moshes se percaktuar ne Ligj) per te perfituar nje kthim maksimal nga investimi, per te permiresuar standartin e jeteses ne moshen e pensionit dhe per te evituar penalitetet ne rast terheqje te parakohshme.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë nje premtim apo garanci per kthimin ne te ardhmen. Te gjithë shembujt e tjere numerike, jane perdorur per qellime ilustrative dhe analize te te dhenave historike, dhe nuk duhen perdorur nga investitorët per te nxjerre konkluzione per te ardhmen.

Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitese e fondit nuk garantojnë nje kthim te caktuar te fondit.

Informacioni mbi cmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sha, në web site [www.raiffeisen-invest.al](http://www.raiffeisen-invest.al), ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.